



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:117945

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554190

PKR.nr.327/2007

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët **Drilon Haraçia** - Kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesional – **Nikollë Komani dhe Njazi Morina** - anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale ndaj të akuzuarit SH.B., nga Skenderaj, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë me numër PP.nr.188/2001, të datës 04.12.2007, tani Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor – publik me datën: 21.11.2023, 21.12.2023, 13.02.2024 dhe 07.03.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Petrit Kryeziu nga Prokuroria Themelore në Prizren, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.Bedri Miftari nga Mitrovica, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 11.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datë 05.04.2024**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

SH.B., i biri i ... nënës ..., e gjinisë ..., i lindur me dt... në ..., ku edhe banon rr. “..” - Banesat sociale, i pa shkolluar, i papunë, përfitues i socialit, i martuar, ati 6 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 të KPP-së

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse me datën 30.03.2000, rreth orës 23:45 minuta, në ...j, në lokalit “...” pronë e të dëmtuarit S.L., pas një fjalosje me të dëmtuarin B.M., i njëjti ka shkuar me automjetin e vet të parkuar para lokalit është armatosur me armë gjysmë automatike të markës “Kallashnikov” (RPK) të cal.7.62 mm, me numër serik 90324990, dhe i vetëdijshëm se mund ta privon nga jeta tjetrin, pasi që në vendin kritik ka pasur qarkullim të madh njerëzish, disa herë ka shtënë në drejtim të dëmtuarit B.M., derisa ky po qëndronte pas automjetit të markës “. . . 3” me NN auto targa pronë e të dëmtuarit F.M., dhe “. . .” . . me NN auto targa pronë e të dëmtuarit I.L., mirëpo i dëmtuari arrin që të fshehët pas këtyre automjeteve dhe predhat nuk e godasin pastaj intervenojnë qytetarët që ta pengojnë që të mos vazhdojë me të shtëna dhe vepra ka ngel në tentativë.

- **Me çka kishte për të kryer veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.**

- Familjarët e të dëmtuarit B.M., tani i ndjerë, për kompensimin e dëmit u udhëzuan në kontest të rregullt juridiko – civil.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, tani Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.188/2001, të datës 04.12.2007, ndaj të akuzuarit SH.B., nga Skenderaj, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

- Gjykata ka konstatuar se kjo çështje është pranuar në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjakovë sipas Marrëveshjes së Kryetarëve të gjykatave dhe KGJK-së që kjo çështje të gjykohet në Gjykatën themelore në Gjakovë për shkak të ngarkesës së madhe të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
- Po ashtu këtë çështje do ta përfaqësojë prokurori nga prokuroria Themelore në Prizren meqenëse edhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka bërë transferimin e lëndëve në Prokurorinë Themelore në Prizren.
- I akuzuari dhe mbrojtësi i tij dhe i dëmtuari nuk kanë vërejtje lidhur me kompetencën E Gjykatës dhe të trupit gjykues.

I akuzuari SH.B., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës.

Prokurori i Shtetit Petrit Kryeziu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës i cili fjalën përfundimtare e ka paraqitur në formë të shkruar duke dhënë arsyet se akuza është bazuar (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.07.03.2024).

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Bedri Miftari, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të cilën e ka paraqitur në formë të shkruar duke dhënë arsyet se akuza është e pa bazuar (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.07.03.2024).

I akuzuari SH.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi deklarinimin e mbrojtësit dhe tjetër nuk kam se çka të shtojë.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari SH.B., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas akuzës, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë administrimin e prova si: dëshmia e dëshmitarëve A.H., S.L., D.B., H.B., dhe F.M., leximi i dëshmisë së dëshmitarit S. S.L., si dhe janë administruar provat materiale si:

- Shkresat e lëndës HEP.nr.149/2002 që ka të bëjë me zbatimin e hetimeve kundër të pandehurit SH.B., dhe të pandehurit – tani të ndjerë B.M.,;
- Raporti - përmbledhje e rastit e të shtënave të përpiluar nga Policia e UNMIK-ut lidhur me rastin e datës 31.03.2000;
- Raportit të hetimeve të datës 04.09.2001;
- Raporti i incidentit lidhur me rastin, i datës 27.06.2000;

- Lista e dëshmimeve të datës 31.03.2000;
- Lista e armëve të datës 31.03.2000;
- Listës së armëve të datës 03.04.2000;
- Fotoalbumi i vendit të ngjarjes ;
- Skicës së vendit të ngjarjes;
- Një fotografie të akuzuarit ku është fotografuar me një pushkë automatike;
- Raporti i Policisë së Unmik-ut lidhur me rastin e ndodhur;
- Fotot nga vendi i ngjarjes ku është fotografuar automjeti . . . lidhur me dëmtimet e pësuar.
- I akuzuari SH.B, në shqyrtimin gjyqësor është mbrojtur me heshtje.

2.1. Deklarimet e dëshmitarëve

2.1.1 Dëshmitari A.H., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 30.03.2000 rreth orës 23:45/h kam qenë në lokalin ..., pronar ka qenë S.L., unë nuk ka parë asgjë, kam qenë brenda në lokal dhe SH.B., nuk e kam parë dhe as B.M., nuk kam parë mosmarrëveshje brenda në lokal, vetëm më ka rrok plumbi ku unë kam qenë duke pirë në shank-banak, dhe më ka rrok plumbi në këmbë. Lokali ka qenë full i mbushur plotë, pasi që nuk ka pasur lokale shumë, e ka pas shumë njerëz. Ka shtuar se kam dhënë edhe në Mitrovicë, disa herë kam dhënë deklaratat, nuk më kujtohet, vetëm më kujtohet kur kam deklaruar para gjyqtarit në Gjykatën e Mitrovicës dhe i përmbahem të njëjtës. Prokurori ia ka rikujtuar deklaratën e dhënë para zyrtarëve të Unmikut, ku në faqen e 1-rë, B.I., në njërën anë dhe SH.B., në anën tjetër, por nuk kam dëgjuar se për çka përlesheshin, unë kam par se pas kësaj përleshje Sh... ka dal i pari vetëm dhe është kërcënuar se do të kthehet me armë me veturën e tij”, në rreshtin e 7-7ë, vazhdonin dëshminë duke deklaruar “pas një kohe të shkurtër Sh.. është kthyer në kafe duke mbajtur armë me vete, këtë kam mundur ta identifikojë si 20-tshe armë automatike AK 47”, a ju kujtohet a keni dhënë këtë deklaratë? Dëshmitari ka deklaruar se jo, nuk më kujtohet, kurrë nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet deklarata, por të njëjtën e kam dhënë me vullnet, pasi që kam qenë i plaguar. Po e konfirmojë se është nënshkrimi im, mbi deklarinimin e dëshmitarit nr.HEP149/02 të datës 15.09.2007. Prokurori e ka ballafaquar me që sot deklaruar se me datë 30.03.2000, nuk keni parë asgjë, përderisa në dy deklaratat e dhëna njëra pranë zyrtarëve hetues të Unmik-ut, tri ditë pas ngjarjes, dhe tjera pranë gjyqtarës hetuese në tetor të vitit 2007 vërtetojnë që ju keni parë aq shumë sa që keni identifikuar edhe armën e saktë që e ka pasur në duar këtu i akuzuari, a i qëndroni pranë deklaratave që i keni dhënë më parë e që kanë qenë më të freskëta për rastin apo asaj që e jepni sot? Dëshmitari ka deklaruar se qëndrojë pranë deklaratës së sodit, pasi që në atë kohë kam qenë i dehur, probleme shëndetësore fizike kam pasur por psikike jo. Ka vazhduar tutje se më ka rrokur plumbi prej së jashtme, në anën e majtë të këmbës ku isha në banak të lokalit duke pirë. Nuk e di se kush ka gjuajtur përjashta me armë. Kam pyetur por nuk kam marrë vesh, kam qenë i interesuar me e ditë por nuk më ka treguar askush. Gjykata e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë dhe i njëjti kishte deklaruar në gjykatë në Mitrovicë kur jeni pyetur “se nga kush jeni plagosur”, ju jeni përgjigjur” Se kam pyetur dhe më kanë thënë se B.M.,ka gjuajtur, kështu në kanë thënë në lokal”. A është e vërtetë kjo? Dëshmitari ka deklaruar se është e vërtetë është kjo çka kam deklaruar. Banaku ka qenë në anën e majtë të lokalit, ndërsa xhamat në anën e djathtë, unë kam qenë i kthyer nga banaku dhe jam plagosur në këmbën e majtë nga pjesa e djathtë.

2.1.2 Dëshmitari S.L., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se më kujtohet fort mirë sikur sot ngjarja kritike dhe atë natë e kam parë SH.B., po ashtu edhe B.M., dhe kanë qenë në lokal ka pasur edhe klientë të tjerë, si dhe ka qenë edhe A.H., kanë qenë klientë të rregullt, nuk e di se çka kanë pasur këta dy mosmarrëveshje, mirëpo mos me pas diçka nuk kishte ndodhur kacafytja, nuk i kam dëgjuar, pasi që isha duke shërbyer. Unë më thelbësore më kujtohet se kur ka ardhur Sh... me pushkë gjysmë automatike ka hyrë në lokal, unë kam vepruar dhe e kam qit për jashtë lokalit, në

atë moment nuk e di sa ka zgjatur ajo veç kur i kam dëgjuar krismat në mënyrë automatike, pastaj unë jam plagosur brenda në lokal dhe A.H., ku mandej kam shkuar në spitalin më të afërt në Skenderaj. Ka pasur shumë krisma, sa e di unë janë përdorur dy lloj armësh, ku janë shpuar edhe disa kerr ku ka qenë edhe kerr jam aty, dhe disa të tjerë aty të cilët kanë qenë të parkuar. Unë nuk e kam parë që dikush tjetër të ketë pasur armë. Në drejtim të hyrjes së lokalit, ku jam plagosur edhe unë. Gjatë të shtënave me armë nuk kam parë ndonjë person duke shtënë, pasi që unë kam qenë brenda e ata kanë qenë jashtë, jam i plagosur në anën e majtë përfundi gjurit, sa më kujtohet kanë qenë plumba dum dum, dhe plumbi më ka mbetur brenda, dhe më është dashtë me operacion me e hjek në QKUK në Prishtinë. Përshkruan lokalin banaku ka qenë përball hyrjes, ndërsa unë në momentin e plagosjes kam qenë 1 metër larg banakut, ndërsa nuk më kujtohet se në cilin pozicion kam qenë. Sqaron fillimisht lokalin dhe automjetin e tij i cili ka qenë i parkuar në anën e djathtë të rrugës kryesore ku pjesa e pasme e automjetit ka qenë nga lokali dhe pas shikimit të skicës i njëjti deklaron se ka qenë i goditur në pjesën e majtë të përparme nga shoferi ku siç shih sipas deklaramit të tij shkëmbi i armës ka qenë nga drejtimi i lokalit, ndërsa automjetet tjera nuk e di se nga cila pjesë janë goditur dhe nuk e di se të kujt kanë qenë. Ka pasur të shtëna në drejtim të lokalit por gjithashtu gjatë përshkrimit të skicës se ka pasur të shtëna edhe nga lokali në drejtim të veturës suaj lloji . . . që ndodhej në pjesën matan rrugës. Unë kam dëgjuar se kanë shkrepur shumë, muaj me thënë se një okfir i kallashit të jetë harxhuar, por nuk mund ta konstatojë se sa armë kanë qenë. Unë pasi që e kam qit Sh...jashtë, unë menjëherë e kam mbyll derën e lokalit dhe nuk më ka interesuar më asgjë, ndërsa nuk mund ta përshkruaj kohën se sa ka zgjatur kur jam plagosur unë. Dy plumba kanë qenë në derë por unë kam qenë në spital dhe nuk e di se me këtë punë është marrë policia. Këta kanë qenë më përpara në lokal, mbas sa kohe që janë kthyer prapë në lokal nuk e di, Sh.. është kthyer në lokal me armë, ndërsa për B. nuk e kam parë por këta e dinë më mirë pasi që kanë shkuar nëpër shtëpia dhe kanë marrë armë, ndërsa distancën kohore nuk mund ta përshkruaj, vetëm se kur ka ardhur Sh., B... nuk ka qenë në lokal. Unë nuk e di, por dyshimi im është tek Sh...pasi që ka ardhur me armë dhe at tjetrin (B...) nuk e kam parë me armë. Ka qenë një kushëri i imi në emër të ndjerit B. dhe atij i kam thënë se unë me B... nuk kam asgjë të bëjë, shton se B... ka qenë edhe në spital me më pa, i cili më ka thënë në spital se më ka ardhur keq që ka ndodhur kjo ngjarje, ndërsa nuk e ka përmendur se ka gjuajtur at natë me armë.

2.1.3 Dëshmitari D.B. , në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se natën kritike kam qenë në Skenderaj në lokalin ... kam qenë me H.B., B...A.S., pronarin e lokalit ku kemi pirë atë natë. Më kujtohet që e kam dhënë një deklaratë, ata më kanë pyetur anglisht, diçka me duar bëjshin, përkthyes nuk ka pasur, kanë hallakat diçka në lokal, nuk më kujtohet, se nuk ka pasur përkthyes, ata më kanë marrë në pyetje në banesën time dhe kanë kontrolluar. E di që me gishta ma bojshin, dikush i ka quar ata, por kush nuk e di, më vetën për rast se si ka ndodhur, dhe ma benën se kush ka qiti- shut, unë i thash se ka qit B..., qikaç më kujtohet. Atë natë 80% kemi qenë të dehur dhe e di se janë afruar Sh... me B., janë ngatërruar me fjalë, ja nisi me shajtë B..., ky i thonte se pse po shan, e mandej jemi dal jashtë, dhe i thojke B., se ki me pa, e mandej ka shkuar B... tek kerri e ka marr një kallash dhe ka gjuajtur në drejtim të derës së lokalit dhe e ka plagosur S... dhe A..., ka ngajt B...te kerri e ka marrë kallashin dhe ka gjuajtur në drejtim te dera. Unë isha jashtë lokalit, 10 metra larg derës së lokalit, po ashtu edhe Sh.. e kam pasur larg në të njëjtën distancë, nuk e kam parë që ka pasur armë Sh..., pasi që ka qenë terr. Prokurori ia ka rikujtuar deklaratën e dhënë në kohën kur e ka pasur të freskët rastin me datën 06.04.2000, cili kishte deklaruar në rreshtin e 6-të, të deklaratës “pas përleshjes Sh.. ka shkuar nga kafeneja duke na premtuar se do të kthehet i armatosur”, më pas në rreshtin 12 keni vazhduar deklaratën tuaj duke deklaruar “kur kemi shkuar tek kafeneja kam parë se Sh...e kishte të drejtuar armën në drejtimin tonë, në ato momente ai fillojë të shtie nga arma në drejtimin tonë”, ndërsa sot e deklaroni të kundërtën, çka ju ka bërë që të keni ndryshim thelbësor të deklaratës tuaj? Dëshmitari ka deklaruar se unë nuk e kom pa që pa pas, por një pjesë e deklaratë është e vërtetë se çka kam deklaruar, një pjesë tjetër jo, unë shtojë se me pas qit Sh... na kish vra,

por unë e di se ka qit B... nga kerri. Jashtë objektit, ka pas vetura, por 2 a 3 kanë qenë për afërsisht, njërin të S... e kam njohtë, për tjerat nuk e di se të kujt kanë qenë. Vetura e Ske... ka qenë nga ana e lokalit diku nga 7-8 metra. Në lokal kam qenë së bashku me B.M., të ulur në shank dhe të njëjtin e njoh se e kam kushëri të fshatit ..., Komuna Skenderaj. Mund të them se kemi qenë të dehur dhe nuk ka pasur ndonjë arsye tjetër, dhe mendoj se shkaktar ka qenë alkooli që erdhi deri tek sharjet në mes tyre. Me sa më kujtohet 7-10 birra i kam pirë dhe 85%-90% kemi qenë të dehur, mezi rrinim në këmbë. B...në këmbë ka dal pra B., dhe ka gjuajtur, ndoshta ka gjuajtur me vra por unë nuk e di. Ka pasur mundësi plumbat e B., me e rrok kerrin e S.... Dëshmitari ka përshkruar skicën pash shikimit se ka qenë siç është përshkruar me she... e ka goditur me shuplak Sh.... Thekson duke prekur me gisht se automjeti golf ka qenë te ndërtesa shumëkatëshe, ndërsa i akuzuari ka qenë afër derës së lokalit, kurse duke prekur me gisht thekson se automjeti i S.. ka qenë afër lokalit dhe jo në anën tjetër të rrugës. Ne drejtim timin nuk ka shtënë askush. Ndërsa sa i përket skicës nuk është vërtetë se kanë gjuajtur në mua, se me pas gjuajt më kishin vra.

2.1.4 Dëshmitari H.B., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kur ka ndodhur rasti kam qenë në lokal dhe jam larguar para se me ndodhur rasti, pasi që kam pasur për të kryer punë të mijat. Nuk kam qenë dëshmitar okular por vetëm me të dëgjuar kam kuptuar rastin, sipas fjalëve të njerëzve kam dëgjuar se janë plagosur S,,, dhe A,, dhe sipas fjalëve i ka gjuajtur B,,, Kur kam qenë unë në lokal e kam parë B,,, dhe sa kam qenë unë në lokal nuk ka ndodhur ndonjë konflikt verbal apo fizik. Aty është kafe e vogël, kemi qenë duke pirë alkool, nuk e kam marrë me mend se ka pasur telashe serioze, dhe kanë dal që të gjithë, para se me ndodh rasti dhe unë kam dal i fundit nga ta dhe kam vazhduar në shtëpi, nuk kam dëgjuar të shtëna, pasi që unë nuk kam qenë aty, po ashtu edhe nga largësia nuk ka dëgjuar, pasi që shtëpinë e kam larg prej lokalit nja 2 km. Vetura ka pasur por nuk mund ti identifikojë.

2.1.5 Dëshmitari F.M., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se natën kritike kam qenë në lokal atë natë, kam qenë duke punuar si kamerier në atë lokal, në kohën e të shtënave që e përmendët, ku lokali brenda ka pasur një kuzhinë ku në njërin anë ka qenë kuzhina ndërsa në anën tjetër kanë qenë tavolinat, në atë kohë kam qenë në kuzhinë, sa kam dijeni këtë e kam deklaruar edhe më herët, shumicën e kohës kam qenë brenda në kuzhinë dhe nuk kam dëgjuar ndonjë konflikt verbal brenda lokalit, normalisht është edhe kohë e gjatë mirëpo sa e di unë nuk kam dëgjuar asgjë, më kujtohet se kam dhënë deklaratë pra zyrtarëve të Unmik-ut. Në deklaratën e dhënë 3 ditë pas ngjarjes ndër të tjera në rreshtin e 4 dhe 5, të faqes së 1-rë, keni deklaruar se keni parë dy mysafirë duke u përparë në mes vete, këta ishin SH.B., dhe B.I., ku një mysafir tjetër D.B., ishte së bashku me B..., a ju kujtohet kjo? Dëshmitari ka deklaruar se nëse kam deklaruar kështu, ashtu duhet të jetë, por tani në këtë kohë nuk po më kujtohet. Po ashtu në deklaratën e dhënë para zyrtarëve të Unmik-ut gjithashtu keni deklaruar se “Sh...i ka thënë të tjerëve se do të shkojë në shtëpi për ta marrë armën e tij, dhe pastaj ka dal jashtë dhe ka shkuar në veturën e tij”, a qëndroni pranë kësaj deklaratë? Dëshmitari ka deklaruar se po, prapë se prapë mbesë pranë asaj deklaratë, mirëpo tani nuk po më kujtohet se a ka qenë ashtu apo si. Në deklaratën po ashtu keni deklaruar se “Sh... pas një kohe të shkurtë ishte kthyer në kafe, ka hyrë dhe ka pyetur “se a janë dy idiotet ende brenda” Sh... kishte armë jo kallashnikov, por gjysmë automatike me 20 plumba në karikator, a ju kujtohet një gjë e tillë? Dëshmitari ka deklaruar se nuk më kujtohet një gjë e tillë pasi nuk e kam parasysh atë pjesë. Po mbesë në tërësi pranë atij deklarimi mirëpo meqenëse kanë kaluar 23 vite nga ngjarja, ka pjesë ku nuk po më kujtohet se çka kam deklaruar, por e di se kam dhënë deklaratë pranë zyrtarëve të Unmik-ut në gjuhë angleze, nuk e di a ka qenë përkthyesi, por qëndrojë pranë deklaratimeve të atëherëshme. Realisht si ngjarje nuk po më kujtohet por ka pasur të shtëna pasi që kjo ngjarje ka ndodhur. Në deklaratën e dhënë po ashtu ke deklaruar se sapo Sh... ka arritur tek shkallët jashtë, keni dëgjuar të shtëna, së pari një rrafal prej 3-4 plumbave pastaj një rafal më të gjatë kështu që të gjitha së bashku më shumë se dhjetë plumba janë shkrepur, a ju kujtohet një gjë e tillë? Dëshmitari,

është kohë e gjatë, nuk po më kujtohet. Sa di unë ka qenë i plagosur një person aty afër shankut, emrin sa më kujtohet A.. e ka pasur, nuk më kujtohet për dikën tjetër se është plagosur atë natë. Sa i përket kësaj pjese të gjithë personat që kanë qenë aty, ndoshta të nesërmen e kanë diskutuar problemet në mes të Sh... dhe B., por nuk më kujtohet ajo pjesë se kush çka ka thënë, po mu nuk po më kujtohet se cili ka gjuajtur i pari apo i dyti. Po kam pasur veturë ka qenë . . . , ngjyrë e kuqe dhe ka pasur dëmtime prej të shtënave. Sipas skicës vetura me numër A, para lokalit ku ka ndodhur rasti. Nuk po më kujtohet, po siç shihet nga skica se ku është e vendosur automjeti im ka qenë jo nga pjesa e spitalit por nga pjesa e rrugës, e parkuar në drejtim nga rruga. Sipas fotoalbumit, predhat kanë ardhur prej pjesës së rrugës mirëpo siç shihet dëmtime ka edhe nga kjo pjesa tjetër, por nuk mund ta di se kah kanë ardhur predhat nga kjo pjesë, pasi që kanë mundur edhe nga rruga, ndërsa për predhën brenda nuk mund ta di. Pasi që u rikujtova po më kujtohet që edhe S..... ka qenë i plagosur në gju dhe mbesë deklaramit të dhënë në atë kohë.

2.1.6 Dëshmitari S.L., (me propozimin dhe pajtimin e palëve të njëjtit iu bërë leximi i deklaratës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor paraprakë) i cili kishte deklaruar se natën kritike kishte dëgjuar të shtëna armësh dhe kjo ishte gjatë kohës që ishte duke fjetur, kështu që ka dal në tarasë të banesës dhe kishte parë disa njerëz duke lëvizur dhe nuk kishte dëgjuar debat në mes të SH.B. ,dhe B.M.,, sepse ishte duke fjetur dhe nuk e ka pa se kush ka qëlluar dhe pse, pra nuk ka qenë dëshmitar okular.

2.2.Provat materiale

2.2.1. Nga shkresat e lëndës HEP.nr.149/2002 që ka të bëjë me zbatimin e hetimeve kundër të pandehurit SH.B., dhe të pandehurit –tani të ndjerë B.M.,; siç shihet nga këto shkresa procedura hetimore kishte filluar për të dytë të lartcekurit dhe atë për veprat penale të vrasjes në tentativë, pastaj me dt.06.02.2007, për B.M., ishin pezulluar hetimet, për shkak te vdekjes së të ndjerit.

2.2.2.Nga Konstatohet se është bërë shikimi dhe leximi i raportit përmbledhje e rastit të të shtënave të përpiluar nga Policia e UNMIK-ut lidhur me rastin e datës 30.03.2000; ku janë përshkruar veprimet hetimore dhe sipas hetimeve preliminare si ka rrjedh ngjarja.

2.2.3.Nga raportit të hetimeve të datës 04.09.2001 është përshkruar ku ka ndodhur ngjarja, kush janë të përfshirë, dëshmitarët e rastit si dhe disa veprime hetimore lidhur me rastin.

2.2.4.Nga raporti i incidentit lidhur me rastin, i datës 27.06.2000, ky raport ka të bëjë me B.M., i cili e kishte dërguar në Stacionin Policor avokatin e tij për të treguar vendndodhjen e armës AK-47 dhe vendin ku e kishte fshehur ku zyrtarët policor së bashku me avokatin kishin filluar ta kërkojnë në një fushë por nuk e kanë gjetur. Pastaj kishte ardhur një person dhe e kishte njoftuar për armën dhe iu kishte premtuar se do ta sjell i cili me vonë e ka sjell armën.

2.2.5.Nga lista e dëshmimeve të datës 31.03.2000 janë konstatuar se janë konfiskuar 13 gëzhoja plumbi 7.62x39 dhe 1 fragment plumbi i zbuluar në murin e kafes.

2.2.6.Nga lista e armëve të konfiskuara nga iu dyshuari A.H.,të datës 31.03.2000 është konstatuar se është konfiskuar një (1) AK-47 dhe një (1) karikator.

2.2.6.Nga lista e armëve janë përshkruar 1 njëzetëshe gjysmë automatike 7.62 mm, me numër serik 903 24990 me 20 plumba në karikator; fragment nga plumbi i hekur nga këmba e S... në spitalin e Prishtinës; plumb i hekur nga muri në anën e djathtë të derës së hyrjes në kafen Journal në Skenderaj; 4 gëzhoja të zbrazëta (7.62x39) të gjetura jashtë në anën jugore të kafes Journal; 13 gëzhoja të zbrazëta 7.62x39 mm, të gjetura në rrugë para kafes.

2.2.7.Nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes është fotografuar vendi i ngjarjes lokali jashtë ku ka ndodhur rasti, po ashtu është fotografuar nga brenda, po ashtu janë fotografuar predhat në mur para lokalit dhe gjurmës e gjakut.

2.2.8.Nga skica e vendit të ngjarjes është skicuar lokali, lokacionet e automjeteve të parkuara me shkronjat a, b dhe c, po ashtu janë përshkruar plumbat me shkronjat d, e, f dhe 6, ndërsa me shkronjën h, i, j k dhe l dhe e gëzhojat.

2.2.9.Një fotografie të akuzuarit SH.B., ku është fotografuar me një pushkë automatike, ku sipas zyrtarit policor, Sh.... ka thënë se pushka në fotografi është pushka që ishte në kafetarin ..

2.2.10.Nga raporti i Policisë së Unmik-ut, lidhur me rastin e ndodhur është përshkruar ngjarja dhe personat të cilët janë përfshirë në incident si dhe dëshmitarët e rastit si dhe veprimet e ndërmarra.

2.2.11.Nga fotografitë nga vendi i ngjarjes ku është fotografuar automjeti . . . lidhur me dëmtimet e pësuar, ku shihet xhami thyer nga ana e shoferit, pra në anën e majtë, po ashtu shihet në anën e djathtë xhami me dy predha i shpuar, po ashtu brenda përpara tek predha, po ashtu në anën e djathtë tek brezi i sigurisë si dhe prapa te gypeki predha.

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

2.3.1 I akuzuari SH.B., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë, ndërsa në mbrojtën e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se do ta shfrytëzoi të drejtën time dhe do të mbrohem me heshtje.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë trupi gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 146 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vrasjes e kryen: “*Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim*”.

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Trupi gjykues ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësojë një nga një dhe në lidhshmëri njëra me tjetrën konform nenin 360 paragrafi 2 të KPP-së dhe nuk ka mundur ta vërtetojë gjendjen faktike ashtu siç është akuzuar i akuzuari.

Gjykata ka vërtetuar faktin se natën kritike është e vërtetë se në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit B.M., dhe shokut të tij – dëshmitari D.B., ka pasur një konflikt verbal në lokalit . . . ku janë sharë dhe ofenduar në mes vete dhe sipas dëshmive të dëshmitarëve të gjithë kanë qenë të dehur dhe kishin përdor alkool dhe nuk kanë pasur ndonjë motiv specifik dhe që i akuzuari i ka thënë të dëmtuarit se pritem se tani do të kthehem.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësor në këtë çështje penale dhe administrimit të prova ka ardhë në përfundim se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, pasi që fillimisht nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit për të kryer veprën penale të vrasjes, pra dashja e tij për të kryer këtë vepër penale nuk është vërtetuar po ashtu gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të akuzës pasi që sipas dëshmisë së dëshmitarit **A.H.**, i njëjti ka dëshmuar se unë kam dëgjuar se janë përleshje D.B., dhe B.I M.,) në njërën anë dhe SH.B., në anën tjetër, por nuk kam dëgjuar se për çka përleshin, po ashtu ka dëshmuar se Sh... ka dal i pari vetëm dhe është kërcënuar se do të kthehet me armë, po ashtu pas një kohe të shkurtër Sh... është kthyer në kafe duke mbajtur armë me vete si 20-tshe armë automatike AK 47, kur kanë ndodhur krismat unë kam qenë i kthyer nga banaku dhe jam plagosur në këmbën e majtë nga pjesa e djathtë, më ka rrokur plumbi prej së jashtme, ndërsa ka dëshmuar se kur kam pyetur të nesërmen kam kuptuar se më kanë thënë se B.M., ka gjuajtur, kështu më kanë thënë në lokal. Gjykata ia ka falur besimin deklaratës së dhënë në Polici dhe pranë gjykatësit hetues asokohe pasi që i njëjti ngjarjen dhe mendimin e ka pasur më të freskëta, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor i njëjti ka aloduar se ka qenë i dehur dhe nuk i kujtohet se çka ka deklaruar, prandaj Gjykata ia ka falur besimin deklaratimeve të dhënë më herët. Po ashtu gjykata nga dëshmitari **S.L.**, i cili ka dëshmuar se i akuzuari me B.M., kanë pasur një mosmarrëveshje por nuk i kam dëgjuar B.M., pastaj ka ardhur Sh... me pushkë gjysmë automatike ka hyrë në lokal, B...nuk ka qenë në lokal, unë e kam qit për jashtë lokalit, unë menjëherë e kam mbyll derën e lokalit dhe nuk më ka interesuar më asgjë, nuk e di sa ka zgjatur ajo veç kur i kam dëgjuar krismat në mënyrë automatike, pastaj unë jam plagosur brenda në lokal dhe A.H., ndërsa nuk mund ta përshkruaj kohën se sa ka zgjatur kur jam plagosur unë. Ka pasur shumë krisma, sa e di unë janë përdorur dy lloj armësh, ku janë shpuar edhe disa vetura ku ka qenë edhe vetura ime aty, dhe disa të tjerë aty të cilët kanë qenë të parkuar. Gjatë të shtënave me armë nuk kam parë ndonjë person duke shtënë, pasi që unë kam qenë brenda e ata kanë qenë jashtë, jam i plagosur në anën e majtë përfundi gjurit. Ka pasur të shtëna në drejtim të lokalit, dy plumba kanë qenë në derë, ka shtuar se B... i ndjeri ka qenë edhe në spital me më pa, i cili më ka thënë në spital se më ka ardhur keq që ka ndodhur kjo ngjarje, ndërsa nuk e ka përmendur se ka gjuajtur at natë me armë. Gjykata ia ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit lidhur me ngjarjen se e ka përshkruar se e ka pa Sh... me arme dhe se ka pasur gjuajtje si dhe që është lënduar si dhe që i akuzuari me B.. M.. kanë pasur një mos marrëveshje, po ashtu deklarata e tij përputhem edhe me deklaratimet e dëshmitarëve të tjerë dhe provat materiale. Po ashtu nga deklarimi i dëshmitarit **D.B.**, (i cili natën kritike ka qenë në shoqëri me B.M.,) i cili kishte dëshmuar në polici se ka shtënë më armë B...edhe pse e ka kontestuar mënyrën e marrjes në pyetje nga ana e zyrtarëve policor të Unmiku-ut edhe pse i njëjti e kishte nënshkruar deklaratën dhe kishte përthyesë siç shihet nga deklarata, por i njëjti ka deklaruar se nuk kam kuptuar për këtë pjesë të njëjtit iu është bërë edhe një bastisje pasi që siç po shihet meqë ka qenë në shoqërim të B.M., pasi që e ka pasur shok është dyshuar se mos ka qenë i përfshirë në këtë rast andaj mund edhe të mos këtë thënë të vërtetën, i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kemi qenë të dehur dhe Sh... me B.. janë ngatërruar me fjalë, ja nisi me shajhtë B..., ky i thoshte se pse po shan, e mandej jemi dal jashtë, dhe i thojke B.. , se ki me pa, e mandej ka shkuar B... tek kerri e ka marr një kallash dhe ka gjuajtur në drejtim të derës së lokalit dhe e ka plagosur S... dhe A..., kjo pjesë është cekur ne shqyrtimin gjyqësor, i njëjti ka deklaruar se Sh... nuk ka pasur armë gjë për të cilën ky dëshmitar me herët kishte deklarua se “kur kemi shkuar tek kafeneja kam parë se Sh.. e kishte të drejtuar armën në drejtimin tonë, në ato momente ai fillojë të shtie nga arma në drejtimin tonë”, mirëpo gjatë shqyrtimit ka shtuar se me pas qitë Sh.. na kish vra, por unë e di se ka qit B... nga vatura e tij . . . Ndërsa sa i përket motivit ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë arsye përveç alkoolit. Ne drejtim timin nuk ka shtënë askush. Ndërsa sa i përket skicës nuk është vërtetë se ka gjuajtur në mua, se me pas gjuajt më kishin vra, Gjykata ia ka falur pjesërisht besimin deklaratimit të këtij dëshmitari se sipas dëshmive të dëshmitarëve është vërtetuar se B.M., ka shtënë me armë pasi që kjo vërtetohet nga provat materiale dhe se i ndjeri B... kishte shtënë në drejtim të lokalit ku i kishte plagosur dëshmitarin A.H., dhe S.L., mirëpo nuk ia ka falur besimin

dëshmitarit për pjesën kur ka dëshmuar se Sh....nuk i kam parë armë pasi që kjo nuk është e vërtetë shtuar këtu faktin se edhe në deklarimin e tij kishte thënë se nuk e di kush ka shtënë i pari, por kjo Gjykatë konsideron se dëshmia e tij e dhënë në polici është më pak e besueshme pasi që i njëjti ka qenë në shoqëri të B. dhe ka konsideruar se mund të jetë i involvuar në rast kjo marr parasysht edhe provat tjera si dëshmitë e dëshmitarëve tjerë dhe provave materiale. Nga dëshmia e dëshmitarit **F.M.**, i njëjti ka dëshmuar se natën kritike kam qenë në lokal, kam qenë duke punuar si kamerier në atë lokal, në kohën e të shtënave kam qenë në kuzhinë, ndërsa në deklaratimet e dhënë në polici kishte deklaruar se kam parë dy mysafirë duke u përparë në mes vete, këta ishin SH.B., dhe B.I., ku një mysafir tjetër D.B., ishte së bashku me B...Po ashtu Sh... i ka thënë të tjerëve se do të shkojë në shtëpi për ta marrë armën e tij, dhe pastaj ka dal jashtë dhe ka shkuar në veturën e tij”, dhe pas një kohe të shkurtë ishte kthyer në kafë, ka hyrë dhe ka pyetur “se a janë dy idiotet ende brenda” Sh... kishte armë jo kallashnikov, por gjysmë automatike me 20 plumba në karikator, pastaj kishte deklaruar se sapo Sh.. ka arritur tek shkallët jashtë, keni dëgjuar të shtëna, së pari një rrafal prej 3-4 plumbave pastaj një rrafal më të gjatë kështu që të gjitha së bashku më shumë se dhjetë plumba janë shkrepur, po mu nuk po më kujtohet se cili ka gjuajtur i pari apo i dyti, kam pasur veturë ka qenë . . . , ngjyrë e kuqe dhe ka pasur dëmtime prej të shtënave, sipas skicës vetura me numër A, para lokalit ku ka ndodhur rasti. Nuk po më kujtohet, po siç shihet nga skica se ku është e vendosur automjeti im ka qenë jo nga pjesa e spitalit por nga pjesa e rrugës, e parkuar në drejtim nga rruga. Sipas fotoalbumit, predhat kanë ardhur prej pjesës së rrugës mirëpo siç shihet dëmtime ka edhe nga kjo pjesa tjetër, por nuk mund ta di se kah kanë ardhur predhat nga kjo pjesë, pasi që kanë mundur edhe nga rruga, ndërsa për predhën brenda nuk mund ta di, Gjykata ia ka falur besimin deklaratimit të dëshmitarit të dhënë në asokohe pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor i njëjti është arsyetuar se nuk po me kujtohen pasi që kanë kaluar 23 vite dhe po ka pjesë ku nuk po më kujtohet se çka kam deklaruar, andaj Gjykata ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari pasi që ka lidhshmëri me deklarimin e dëshmitarëve tjerë dhe me provat materiale. Nga dëshmia e dëshmitarit **H.B.**, i cili ka dëshmuar se nuk kam qenë dëshmitar okular kur kanë ndodhur të shtënat, pasi që unë kam qenë në lokal dhe jam larguar para se me ndodhur rasti, sa kam qenë unë në lokal e kam parë B... dhe sa kam qenë unë në lokal nuk ka ndodhur ndonjë konflikt verbal apo fizik. Kam dëgjuar fjalë pas rastit se janë plagosur S...dhe A.. dhe sipas fjalëve i ka gjuajtur B...Gjykata konsideron se dëshmia e këtij dëshmitari është irelevante për këtë çështje pasi që i njëjti nuk ka qenë dëshmitar okular kur kanë ndodhur të shtënat. Po ashtu nga dëshmia e **S.L.**, i cili kishte deklaruar se natën kritike kishte dëgjuar të shtëna armësh dhe kjo ishte gjatë kohës që ishte duke fjetur, kështu që ka dal në tarasë të banesës dhe kishte parë disa njerëz duke lëvizur dhe nuk kishte dëgjuar debat në mes të SH.B., dhe B.M., sepse ishte duke fjetur dhe nuk e ka parë se kush ka qëlluar dhe pse, pra nuk ka qenë dëshmitar okular. Gjykata konsideron se dëshmia e këtij dëshmitari është irelevante për këtë çështje pasi që i njëjti nuk ka qenë dëshmitar okular kur kanë ndodhur të shtënat. Po ashtu është vërtetuar se nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes se jashtë lokalit janë fotografuar predhat para lokalit dhe gjurmës e gjakut, po ashtu nga skica e vendit të ngjarjes është skicuar lokali, lokacionet e automjeteve të parkuara me shkronjat a, b dhe c, po ashtu janë përshkruar plumbat me shkronjat d, e, f dhe 6, ndërsa me shkronjën h, i, j k dhe l dhe e gëzhojat. Po ashtu nga fotografitë nga vendi i ngjarjes ku është fotografuar automjeti . . . lidhur me dëmtimet e pësuar, shihet xhami thyer nga ana e shoferit, pra në anën e majtë, po ashtu shihet në anën e djathtë xhami me dy predha i shpuar, po ashtu brenda përpara tek predha, po ashtu në anën e djathtë tek brezi i sigurisë si dhe prapa te gypeki predha. Po ashtu nga shkresat e lëndës së hetimeve është vërtetuar se B.M., (tani i ndjerë) ka qenë subjekt i hetimit në këtë çështje penale për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë ku ishin pezulluar hetimet, për shkak te vdekjes së të ndjerit.

Gjykata duka marr për bazë dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur si dhe provat materiale ka vërtetuar se i akuzuari me B.M., kanë pasur një konflikt verbal ne mes vete ku i akuzuari kishte marr armën dhe ishte kthyer në lokal me armë, kur është kthyer në S.L., dhe A.H., ku pasi që ka

dal nga lokali sipas dëshmitarëve janë dëgjuar të shtëna ku pastaj janë plagosur dëshmitari S.L., dhe A.H., sipas dëshmitarëve B.M., ka thënë me armë nga ana përball lokalit dhe kishte gjuajtur në drejtimin e Sh... duke e goditur lokalin dhe dy të dëmtuarit e cekur më lartë, kjo vërtetohet edhe me deklarinimin e dëshmitarit F.M., i cili kishte deklaruar se ka dëgjuar 3-4 krisma ku sipas skicës së vendit dhe fotografive të vendit të ngjarjes këto kanë qenë plumba të drejtuar nga lokali me të cilin ka shtënë B.M., i pari, pastaj një rrafal sipas dëshmitarit dhe provave materiale ka shtënë Sh...., pra është vërtetuar se edhe i akuzuari ka shtënë me armë, pasi që kjo vërtetohet nga provat materiale siç është skica e vendit të ngjarjes dhe fotoalbumi i automjeteve të dëmtuara të cilat kanë qenë në anën tjetër të rrugës, mirëpo Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj faktin fillimisht se kush ka shtënë i pari i akuzuari apo B., pasi që dëshmitari D. ka deklaruar se po të kishte shtënë Sh...na kishte vrarë dhe ka dëshmuar se B.M., nga automjeti i tij Golf ka shtënë me AK-47, po ashtu nuk kemi mundur të vërtetojmë saktë se me rastin e shtënës me armë ku ka qenë B.M., pra lokacioni a ka qenë pas vetura sipas pretendimeve të akuzës apo ka qenë brenda në veturë sipas dëshmitarit D., po ashtu nuk është bërë ekspertizë balistike lidhur me predhat e gjetura në vendin e ngjarjes apo në makinat e dëmtuara se a janë shkrepur nga një apo dy armë edhe pse vet logjika dhe marr parasysh edhe dëshmitë të dëshmitarëve sidomos të dëshmitarit S.L., se ka pasur dy armë që janë përdorur, pra të gjitha këto prova të cilët nuk janë ekzaminuar nuk mund të vërtetojmë pretendimet në akuzë, Gjykata ka ardhë në përfundim se në bazë të provave të administruara nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë, pasi që fillimisht nuk është vërtetuar se i akuzuari ka shtënë në drejtim të dëmtuarit B.M., i cili edhe nuk është goditur me asnjë predhë po ashtu B.M., tani i ndjerë përball rrugës dhe lokalit ka shtënë në drejtim të lokalit për ta goditur të akuzuarin ku predhat futen në brendësi të lokalit ku e godasin të dëmtuarit S.L., dhe të dëmtuarin A.H., ndërsa Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj fillimisht faktin se i dëmtuari B.M., a ka qenë prapa makinës për të goditur apo brenda, po ashtu edhe pse sipas skicës së vendit të ngjarjes vërtetohet se ka pas shkëmbim zjarri mirëpo nuk është vërtetuar se nga cilët armë kanë ardhë këto goditje të predhave pasi që nuk kemi ekzaminim balistik, pasi që kemi dy makina të dëmtuara dhe dy të dëmtuar brenda lokalit, pra kjo Gjykatë nuk ka mundur fillimisht të vërtetoj dashjen se i akuzuari ka dashur ta privoj nga jeta të dëmtuarin B.M., andaj Gjykata nuk ka mundur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë për të cilën ngarkohet, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale andaj duke u bazuar në nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPP, të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale të lartcekur të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilat ngarkohet dhe vendosi që njëjtin ta liroj nga akuza, duke marr parasysh faktin se gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes ka obligim ligjor që të provojë të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pakontestueshme, pra faktet që shkojnë në favor të akuzuarit e në veçanti lidhur me nenin 3 të KPP-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj, po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshem dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë, kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

6. Vendimet e trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, Gjykata të akuzuarin SH.B., në mungesë të provave e ka liruar nga akuza për veprën penale vrasje në tentativë 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

7. Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.3 të KPP-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bijnë në mjetet buxhetore të gjykatës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.327/07, me datë 05.04.2024

**Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjykses- Gjykatësi,
Drilon Haraçia**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.